



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 25 tetor 2021

Nr.ref.:RK 1876/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI56/21

Parashtrues

Emrush Berisha

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
Pml. nr. 275/20, të 9 nëntorit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Emrush Berisha, me vendbanim në fshatin Mirosal, komuna e Ferizajt (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga Berat Tmava, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit Pml. nr. 275/20, të 9 nëntorit 2020, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në ndërlidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, PA1. nr. 27/2020, të 28 shkurtit 2020 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), P. nr. 4232/2019, të 11 tetorit 2019.
3. Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme parashtruesi i kërkesës e ka pranuar më 26 nëntor 2020.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 19 mars 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 22 mars 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha (anëtarë).
8. Më 26 mars 2021, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dorëzua Gjykatës Supreme.
9. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP.71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.

10. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së punës, gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.
11. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, përmes Vendimit nr. KSH. KI56/21, për zëvendësimin e gjyqtarit raportues, caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese në vend të gjyqtarit Bekim Sejdiu.
12. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP.71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese.
13. Më 7 tetor 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Bazuar në shkresat e lëndës, më 20 qershor 2019, Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm (në tekstin e mëtejme: Prokuroria Themelore) kishte ngritur aktakuzë [PP. II. nr. 4232/19] kundër parashtruesit të kërkesës, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 370, par. 9 dhe 8 lidhur me paragrafin 6 dhe paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPRK).
15. Më 11 tetor 2019, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [P. nr. 4232/2019] kishte vendosur: (i) parashtruesi i kërkesës ishte shpallur fajtor për shkak të kryerjes së veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 370, par. 9 dhe 8 lidhur me nenin 6 dhe 1 të KPRK-së dhe ishte dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjet e 6 (gjashtë) muaj; (ii) konform nenit 59, par. 1 dhe 2, pika 2.6 lidhur me nenin 65 të KPRK-së, parashtruesit të kërkesës i ishte shqiptuar dënim plotësues, marrja e lejes së vozitjes të kategorisë “B”; dhe (iii) të dëmtuarit D. S. dhe E. B., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike ishin udhëzuar në kontest civil.
16. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë pranë Gjykatës së Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin, me propozimin që të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet aktgjykimi i ankimuar dhe lënda t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje. Ankesë kishte parashtruar edhe Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë.
17. Më 28 shkurt 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PA. 1. nr. 27/2020] kishte vendosur: (i) me rastin e ankesës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe ankesës së mbrojtësit të parashtruesit të kërkesës, Aktgjykimi i Gjykatës Themelore ishte ndryshuar, ashtu që parashtruesi i kërkesës për shkak të kryerjes së veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 370, par. 9 dhe 8 lidhur me nenin 6 dhe 1 të KPRK-së dënohet me dënim

me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet e 6 (gjashtë) muaj, duke ia llogaritur në dënimin e shqiptuar edhe kohën e kaluar në arrest shtëpiak prej 21 majit 2019 deri më 11 tetor 2019; (ii) ia ndalon marrjen e lejes së vozitjes në afat prej 1 (një) viti, nga dita e përfundimit të vuajtjes së dënimit të lartshqiptuar; dhe (iii) pjesa tjetër e aktgjykimit të ankimuar mbetet e pandryshuar.

18. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë pranë Gjykatës Supreme, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, par. 2 nënparagrafi 2. 1 dhe shkelje të ligjit penal nga neni 385, par. 1 nënparagrafi. 1. 2, me propozim që kërkesa të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimet e gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë të anulohen dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.
19. Më 9 nëntor 2020, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 275/2020] refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të parashtruar nga parashtruesi i kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të KEDNJ-së.
21. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta me aktgjykimet e tyre kanë shkelur nenin 248 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPPK), si dhe nuk kanë vërtetuar në mënyrë të plotë gjendjen faktike, për arsye se, siç thekson ai: (i) te pranimi i fajësisë, gjykata duhet të ketë kujdes se i pandehuri a e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë. Këto rrethana gjykata i përcakton vetëm pasi të ketë njoftuar të pandehurin për pasojat konkrete të pranimi të fajësisë siç janë: se pranimi i fajësisë është rrethanë lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit, pranimi i fajësisë për gjykatën do të thotë edhe pendim, se shqyrtimi gjyqësor mbahet pa kaluar në procedurën e provave pa pasur dilema në ndonjë prej provave që gjinden në dosje të lëndës. Këto informata i akuzuari duhet që t' i merr nga gjykata, e që në rastin konkret nuk është vepruar kështu; dhe (ii) gjykatat kur kanë vendosur lidhur me këtë çështje juridiko-penale, është dashur që të evidentohen shkeljet e ligjit penal lidhur me ekspertizat e ekspertëve të komunikacionit dhe të vijë në një konkludim të drejtë dhe të saktë, duke pasur parasysh faktin se pas pranimi të fajësisë nga ai, sipas tij, nuk ishin vlerësuar drejtë provat që gjinden në dosje të lëndës dhe me këtë ka rezultuar edhe me përgjegjësinë penale në dëm të tij.
22. Sipas parashtruesit të kërkesës, ende pa u lexuar aktakuza, ai ishte deklaruar i fajshëm dhe ka ndjerë keqardhje për aksidentin që kishte ndodhur dhe që nga fillimi i kishte kërkuar falje familjes së viktimës, dhe se ka qenë hera e parë që ka ra ndesh me ligjin. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës thekson se po që se ka dilema në ndonjë provë dhe gjyqtari nuk bindet se janë vërtetuar të gjitha faktet, atëherë gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues janë të

detyruar që në seancën gjyqësore me aktvendim të veçantë në procesverbal, mos ta aprovojnë pranimin e fajësisë.

23. Më tej, parashtruesi i kërkesës pohon se sipas ekspertizës të përpiluar nga eksperti i komunikacionit, është konstatuar se *"Aksidentit i ka kontribuar edhe koha me erë të fortë e cila i ka rrëzuar shenjat, duke e bërë edhe sigurimin e vendit jo të mjaftueshëm, e që në rrethanat ekzistuese me një organizim më të mirë ndoshta më mirë do të ishte të ndërpriteshin punët dhe shiriti të hapej për qarkullim nuk janë ndërmarrë masat adekuate të nevojshme. Nuk ka mjaftuar shtrirja e shenjave siç ka deklaruar mbikëqyrësi i punës-këmbësori D2, sepse në atë rast pa shenja mbrojtëse paralajmëruese zona punuese ka qenë me rrezik të lartë si për dy punëtorët po ashtu edhe për pjesëmarrësit në trafik, e që fatkeqësisht e vërteton edhe ndodhja e aksidentit që e ngarkon me një përgjegjësi të posaçme kompaninë Bechtel Enka"*.
24. Sipas parashtruesit të kërkesës, gjykatat kur kanë vendosur lidhur me këtë çështje, është dashur që të evidentojnë shkeljet e ligjit penal lidhur me ekspertizat e ekspertëve të komunikacionit dhe të vijnë në një konkludim të drejtë dhe të saktë, duke pasur parasysh faktin se pas pranimin të fajësisë nuk janë vlerësuar drejtë provat që gjinden në dosje të lëndës.
25. Parashtruesi i kërkesës thekson se Gjykata Supreme, kur ka vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, është përfshirë në shkelje të të drejtave kushtetuese, sepse siç argumenton ai: *"Gjykata Supreme në rastin e vendosjes fare nuk ka analizuar kërkesën e të dënuarit që të vërtetojë drejtë dhe saktë të gjitha provat që gjinden në dosje të lëndës sipas paragrafit 4 të nenit 31 të Kushtetutës lidhur me nenin 6 të KEDNJ-së"*. Pra sipas tij, Gjykata Supreme refuzimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë nuk e ka arsyetuar dhe se kjo përbën një vendim arbitrar, i cili, sipas tij cenon të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.
26. Tutje, parashtruesi i kërkesës thekson: *"e drejta për të pranuar vendim të arsyetuar përfshin obligimin e autoriteteve të ofrojnë arsye për vendimet e tyre me baza të arsyeshme në nivel procedural dhe material. Një parim në doktrinën e drejtësisë thotë se gjykatësit vendosin brenda ligjit kur ata vendosin për arsye ligjore, siguri i arsyeve kërkon shpjegime me arsye bindëse dhe të ndërtuara mirë për vendimin e marrë në çdo rast individual, i cili duhet të përfshijë që të dyja, kriteret ligjore dhe elementet faktike në mbështetje të vendimit"*. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se kjo përbën shkelje të barazisë së armëve. Parashtruesi i kërkesës i referohet vendimeve të Gjykatës KI120/10 dhe KI72/12, mirëpo pa shtjelluar ngjashmëritë e rastit të tij me këto raste.
27. Parashtruesi i kërkesës po ashtu thekson se: *"qëndrimi i Gjykatës Supreme dhe i Gjykatës Themelore gjatë procedurave të zhvilluara në këtë rast, ka për pasojë që e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së, është shkelur për shkak të dështimit për të dëgjuar dëshmitarët-ekspertët e komunikacionit të cilët i kanë përpiluar ekspertizat e tyre dhe të sqarohen lidhur me përgjegjësinë penale të shkaktarëve të aksidentit"*.

28. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: (i) të shpallë kërkesën e pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së; (iii) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 275/2020 të 9 nëntorit 2020; dhe (iv) Aktgjykimin e Gjykatës Supreme ta kthej në rivendosje.

Dispozitat relevante Ligjore

KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS NR. 06/L-074

VEPRAT PENALE KUNDËR SIGURISË SË TRAFIKUT PUBLIK

Neni 370

Rrezikimi i trafikut publik

- 1. Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe rrezikon jetën e njerëzve apo pasurinë dhe me këtë i shkakton dikujt dëm të konsiderueshëm pasuror, dënohet me gjobë ose me burgim deri në 3 (tre) vjet.*
- 2. Kushdo që shkel cilindo ligj mbi trafikun rrugor apo transportin rrugor dhe me këtë rrezikon trafikun hekurudhor, me tramvaj, me trolejbus, me autobus, me teleferik ose trafikun ujor dhe në këtë mënyrë rrezikon jetën e njerëzve, sigurinë fizike ose pasurinë, dënohet me burgim deri në 5 (pesë) vjet.*
- 3. Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezulton me dëm pasuror në vlerë prej 15 (pesëmbëdhjetëmijë) euro apo më shumë, kryesi dënohet me burgim prej 6 (gjashtë) muaj deri në 5 (pesë) vjet.*
- 4. Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor të ndonjë personi ose dëm pasuror në vlerë prej 20 (njëzetmijë) euro apo më shumë, kryesi dënohet me burgim prej 1 (një) deri në 8 (tetë) vjet.*
- 5. Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej 3 (tre) deri në 12 (dymbëdhjetë) vjet.*
- 6. Nëse vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni kryhet nga pakujdesia, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në 1 (një) vjet.*
- 7. Nëse vepra penale nga paragrafi 6 i këtij neni rezulton me dëm pasuror në vlerë prej 15 (pesëmbëdhjetëmijë) euro apo më shumë, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në 3 (tre) vjet.*
- 8. Nëse vepra penale nga paragrafi 6 i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose dëm pasuror në vlerë prej 20 (njëzetmijë) euro apo më shumë, kryesi dënohet me burgim prej 6 (gjashtë) muaj deri në 5 (pesë) vjet.*

9. Nëse vepra penale nga paragrafi 6 i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej 1 (një) deri në 8 (tetë) vjet.

KODI Nr. 04/L-123 I PROCEDURËS PENALE

Neni 248

Pranimi i fajësisë gjatë shqyrtimit fillestar

1. Kur i pandehuri pranon fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës sipas nenit 246 ose 247 të këtij Kodi, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues përcakton nëse:

1.1. i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit;

1.2. pranimi bëhet vullnetarisht nga i pandehuri pas këshillimeve të mjaftueshme me mbrojtësin, nëse i pandehuri ka mbrojtës;

1.3. pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i Shtetit për plotësimin e aktakuzës të pranuar nga i pandehuri dhe çdo provë tjetër, siç është dëshmia e dëshmitarëve e paraqitur nga Prokurori i Shtetit ose i pandehuri; dhe

1.4. aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

2. Në vlerësimin e pranimin të fajësisë së të pandehurit, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë mendimin e Prokurorit të Shtetit, mbrojtësit dhe të dëmtuarit.

3. Kur gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues nuk bindet se janë vërtetuar faktet nga paragrafi 1 i këtij neni, ai merr aktvendim me të cilin refuzon pranimin e fajësisë dhe procedon shqyrtimin fillestar sikur pranimi i fajësisë të mos ishte bërë.

4. Kur gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues bindet se janë vërtetuar faktet nga paragrafi 1 i këtij neni, ai merr aktvendim me të cilin pranon pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe vazhdon me shqiptimin e dënimit, caktimin e seancës për vërtetimin e ndonjë fakti relevant për dënimin ose pezullon dënimin deri në përfundimin e bashkëpunimit të të pandehurit me Prokurorin e Shtetit.

5. I pandehuri i cili nuk pranon fajësinë gjatë shqyrtimit fillestar mund të ndryshojë deklaratën e tij dhe të pranojë fajësinë në çdo kohë. Për cilindo të pandehur që dëshiron të pranojë fajësinë nga ky paragraf, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues zbaton përshtatshmërisht shqyrtimin nga ky nen.

Pranueshmëria e kërkesës

29. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

30. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

31. Për më tepër, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç janë të përcaktuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individë mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...”.

32. Sa i përket përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë, siç janë cekur më lart, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, ai konteston një akt të autoritetit publik dhe i ka shteruar mjetet juridike në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit. Tutje, parashtruesi i kërkesës ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur nga autoritetet publike, në pajtim me nenin 48 të Ligjit, dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit.
33. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë së kërkesës në pajtueshmëri me rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], nënregullin (2) të Rregullores së punës, që përcakton:

2) "Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtuesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

34. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si "*qartazi e pabazuar*" në tërësinë e saj ose vetëm përkritazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t' iu referohet të njëjtave si "*pretendime qartazi të pabazuara*". Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime "*të shkallës së katërt*"; (ii) pretendime që kategorizohen me një "*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*"; (iii) pretendime "*të pambështetura apo të paarsyetuara*"; dhe në fund, (iv) pretendime "*konfuze dhe të paqarta*" (shih, rastet e GjEDNJ-së, *Kemmachev kundër Francës*, Aplikimi nr. 17621/91, kategoria (i), *Mentzen kundër Lituanisë*, Aplikimi nr. 71074/01, kategoria (ii) dhe *Trofimchuk kundër Ukrainës*, Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii)).
35. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtuesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GjEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
36. Në dritën e kësaj, Gjykata rikujton se parashtuesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta shkelën të drejtat e tij, të garantuara me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të KEDNJ-së.
37. Gjykata vëren se pretendimet e parashtuesit të kërkesës për shkelje të të drejtës për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, kanë të bëjnë me mënyrën se si gjykatat e rregullta kanë interpretuar KPP-në, në rastin e tij. Lidhur me këtë ai pretendon se te pranimi i fajësisë, gjykata duhet të ketë kujdes se i pandehuri a e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë. Këto rrethana sipas tij, gjykata i përcakton vetëm pasi të ketë njoftuar pandehurin për pasojat konkrete të pranimi të fajësisë siç janë: se pranimi i fajësisë është rrethanë lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit, pranimi i fajësisë për gjykatën do të thotë edhe pendim, se shqyrtimi gjyqësor mbahet pa kaluar në procedurën e provave pa pasur dilema në ndonjë prej provave që gjinden në dosje të lëndës. Këto informata i akuzuari duhet që t' i merr nga gjykata, e që në rastin konkret nuk është vepruar kështu. Ai po ashtu thekson se gjykatat kur kanë vendosur lidhur me këtë çështje juridiko-penale, është dashur që të evidentohen shkeljet e ligjit penal lidhur me ekspertizat e ekspertëve të komunikacionit dhe të vijë në një konkludim të drejtë dhe të saktë, duke pasur parasysh faktin se pas pranimi të fajësisë nga ai, sipas tij, nuk ishin vlerësuar drejtë provat që

gjinden në dosje të lëndës dhe me këtë ka rezultuar edhe me përgjegjësinë penale në dëm të tij.

38. Lidhur me këtë, Gjykata fillimisht rikujton se Gjykata Kushtetuese nuk ka jurisdiksion për të vendosur nëse një parashtrues ka qenë fajtor për kryerjen e veprës penale apo jo. Ajo nuk ka as jurisdiksion për të vlerësuar nëse gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë apo për të vlerësuar nëse gjyqtarët e gjykatave të rregullta kanë pasur dëshmi të mjaftueshme për të përcaktuar fajësinë e një parashtruesi të kërkesës. (shih, në këtë kontekst dhe ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI128/18, parashtrues i kërkesës: *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport SH.A., "Adem Jashari"*, Aktvendim i 28 qershorit 2019, paragrafi 55; KI62/19, parashtrues i kërkesës: *Gani Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 dhjetorit 2019, paragrafët 56-57; KI110/19, parashtrues i kërkesës: *Fisnik Baftijari*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 nëntorit 2019, paragrafi 40).
39. Gjykata vë theksin në qëndrimin e saj parimor se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve apo të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë kryer nga Gjykata Supreme apo ndonjë gjykatë tjetër e instancës më të ulët, përveç nëse dhe për aq sa ajo mund të ketë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Gjykata rithekson më tej se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e "shkallës së katërt" në lidhje me vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (shih, në këtë kontekst, rastin e GjEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura aty; dhe shih, gjithashtu, rastet e Gjykatës KI128/18, i cituar më lart, paragrafi 56; dhe KI62/19, i cituar më lart, paragrafi 58).
40. Në këtë kontekst, Gjykata Kushtetuese mundet vetëm të shqyrtojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta, shikuar në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të tillë që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur një gjykim të drejtë ose jo arbitrar (shih, *inter alia*, rastin *Edéards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 13071/87, Raport i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, miratuar më 10 korrik 1991 dhe shih gjithashtu rastet e Gjykatës KI110/19, cituar më lart, paragrafi 41).
41. Në vijim, Gjykata do të trajtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës duke aplikuar praktikën gjyqësore të saj dhe të GjEDNJ-së në harmoni me të cilën Gjykata Kushtetuese, në bazë të nenit 53 të Kushtetutës [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
42. Në raport me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren fillimisht se parashtruesi i kërkesës para Gjykatës Supreme kishte pretenduar se në rastin e tij gjykatat kanë shkelur nenin 248 të KPPK-së, konkretisht me asnjë provë të administruar në shkallë të parë dhe të dytë nuk është vërtetuar se ai ka ndërmarrë veprimet e kryerjes së veprës penale.

43. Për më tepër, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta kishin adresuar të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe ishin arsyetuar vendimet e tyre duke u bazuar në faktet dhe provat relevante për rastin.
44. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht i referohet pjesëve relevante të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, e cila arsyetoi si në vijim:

“Meqë i pandehuri e ka pranuar fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi paraprakisht e ka kuptuar dhe është njoftuar nga gjykata, lidhur me natyrën dhe pasojat e pranimi të kryerjes së veprës penale, pranim i cili është bërë vullnetarisht, si dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësen e tij, pranim i cili mbështetet në faktet e çështjes dhe provat materiale që përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabim faktik. Gjykata vlerësoi se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore nga neni 248 të KPRK-së, që të pranohet deklarata e të pandehurit për pranimin e fajësisë për kryerjen e kësaj vepre penale, dhe të njëjtën edhe e ka aprovuar, ashtu që nuk ka administruar asnjë provë për të vërtetuar gjendjen faktike”.

(...)

Nga thëniet e vet të pandehurit në shqyrtimin fillestar u vërtetua se ai me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj tij, ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Pranimi i fajësisë nga i pandehuri gjen mbështetje në provat që gjenden në shkresat e lëndës siç janë: mendimi i ekspertit mjeko-ligjor Dr. Naim Uka, i datës 17.09.2019, raporti i autopsisë i datës 22.05.2019, mendimi i ekspertit të komunikacionit, i datës 30.05.2019, skica e vendit të ngjarjes dhe fotodokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës.

(...)

Kështu që duke u bazuar në këto dispozita ligjore, gjykata, e ka shpallur fajtor të pandehurin E.B., për shkak të veprës penale, Rrezikim i trafikut nga neni 370 par.9 dhe 8 lidhur me par.6 dhe par.1 të KPRK-së, ngase në veprimet e të njëjtit konsumohen të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtat është penalisht përgjegjës. Kjo për faktin se siç e ka pranuar edhe vetë, i njëjti, ditën kritike, nga pakujdesia, ka shkaktuar aksidentin me fatalitet, ku si pasojë e së cilit përveç se ka vdekur një person, ka pasur edhe të lënduar të tjerë, përfshirë këtu edhe veten e tij, si dhe janë shkaktuar dëme të konsiderueshme materiale. Duke u bazuar në këto që u cekën më lart gjykata ka vendosur që të pandehurin E.B., ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi”.

45. Tutje, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit, pretendimeve të parashtruesit të kërkesës të ngritura në ankesë iu është përgjigjur, si më poshtë:

“Gjykata e Apelit vlerëson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, në të cilat thirret prokurori dhe mbrojtësi i të akuzuarit. Aktgjykimi i ankimuar nuk përmbanë shkelje tjera të cilat kjo gjykatë në pajtim me dispozitat e nenit 394 të KPPK-së i vëren gjithnjë sipas detyrës zyrtare e të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij. Dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është

mjaft i qartë dhe pa kundërthënie me vetëveten dhe me faktet e cekura në arsyetim. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar janë përshkruar në mënyrë të qartë elementet inkriminuese të akuzuarit që përbëjnë veprën penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor në kuptim të dispozitës së nenit 365 të KPPK-së, pra, mënyra si i akuzuari ka kryer veprimet inkriminuese me datë, vend dhe kohë si në dispozitave të aktgjykimit të ankimuar, veprime këto që përmbajnë elemente qenësore të veprës penale për të cilën me të drejtë është shpallur penalisht përgjegjës dhe është gjykuar me dënim me burgim”.

46. Për më tepër, Gjykata Supreme si shkallë përfundimtare gjyqësore, arsyetoi se:

“Sipas vlerësimit të kësaj gjykate pretendimet se aktgjykimet kundër të cilave është paraqitur kërkesa përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nuk qëndrojnë, ngase dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë i vërtetuar me atë të shkallës së dytë është i qartë, i kuptueshëm, konkret dhe nuk ka kundërthënie qoftë me vetveten qoftë me arsyet e parashtruara. Në të qartë janë përshkruar veprimet inkriminuese të dënuarit që e përbëjnë figurën e veprës penale për të cilën është gjykuar dhe për këtë janë dhënë arsye të mjaftueshme, të cilat janë vlerësuar drejt si nga gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë. Duhet të theksohet se i dënuari që në shqyrtimin fillestar me datë 10.10.2019 ka pranuar fajësinë në prani të mbrojtësit dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me të njëjtin. Po ashtu duhet të theksohet se aktgjykimi i cili përpilohet në bazë të pranimit të fajësisë nuk përmban arsyetim të vlerësimit të provave sepse të njëjtat nuk administrohen fare në këtë shqyrtim por përmban vetëm vlerësimin e pranimit të fajësisë dhe vlerësimit të rrethanave të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit të shqiptuar. Në rastin konkret, kjo gjykatë gjen se i dënuari në praninë e mbrojtësit të tij ka deklaruar se e pranon fajësinë dhe gjykata pasi që të njëjtin e ka udhëzuar në kuptim të nenit 246 të KPPK-së, dhe pasi që është bindur se i dënuari ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës dhe janë përmbushur të gjitha kërkesat sipas nenit 248 të KPPK-së ka aprovuar pranimin e fajësisë e në mbështetje të nenit 326 të KPPK-së. Pra, i dënuari vullnetarisht ka pranuar fajësinë sipas pikave të aktakuzës që i është lexuar në prani të mbrojtësit të tij me të cilin është konsultuar lidhur me përparësitë që parashihen me ligj me rastin e pranimit të fajësisë, pra, i njëjti ka qenë plotësisht i vetëdijshëm se cilat veprime të tij i pranon si dhe me pasojat e pranimit të fajësisë.

(...)

Të gjitha këto, e duke u bazuar në shkresat e çështjes, vërtetojnë se i dënuari plotësisht ka qenë i njoftuar me të drejtat e tij dhe me pasojat e pranimit të fajësisë dhe se me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka aprovuar këtë pranim të fajësisë, i cili përveç që është marrë në mënyrë të vullnetshme, është edhe i bazuar në provat të cilat janë në shkresa të çështjes, çka me të drejtë e konstaton Gjykata e Apelit në procedurën ankimore. Sa i përket pretendimit se në shkresa të çështjes ekziston edhe një ekspertizë e komunikacionit në bazë të së cilës kontribut (sekondar) për aksident mban edhe Liridon Trena - ngasësi "B", kjo gjykatë konstaton se Gjykata e Apelit me rastin e ankesës këtë fakt e ka marrë si rrethanë lehtësuese dhe ka vendosur për ndryshimin e vendimit për dënimin duke e

ulur dënimin e shqiptuar, ndërsa Gjykata Supreme vlerëson se ky fakt, pra konstatimi se kontribut (sekondar) për aksident mban edhe Liridon Trena - ngasësi "B", nuk e ndryshon pozitën juridike të të dënuarit. Pra i dënuari edhe sipas ekspertizës së parë dhe asaj të dytë ka qenë përgjegjësi kryesor për shkaktimin e aksidentit, andaj edhe drejtë ka vepruar gjykata e shkallës së parë kur e ka pranuar fajësinë e të dënuarit".

47. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata gjen se vendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, në ndërlidhje me vendimet e gjykatave të instancës më të ulët ishte mjaftueshëm i arsyetuar dhe, rrjedhimisht, plotëson kriteret e vendimit të arsyetuar gjyqësor, të përcaktuara me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1. të KEDNJ-së. Për më tepër, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta i kanë trajtuar me kujdes pretendimet e parashtruesit të kërkesës, sa i përket pranimi të fajësisë dhe marrjes parasysh të ekspertizës, duke arsyetuar tutje se parashtruesi i kërkesës e kishte pranuar fajësinë në prani të mbrojtësit të tij, pasi paraprakisht e ka kuptuar dhe është njoftuar nga gjykata, lidhur me natyrën dhe pasojat e pranimi të kryerjes së veprës penale. Kurse sa i përket marrjes parasysh të ekspertizës së dytë, Gjykata vëren se kjo ekspertizë është marrë parasysh dhe vlerësuar nga ana e Gjykatës së Apelit, ku dhe në bazë të saj parashtruesit të kërkesës i ishte ndryshuar vendimi për dënim duke ia ulur dënimin e shqiptuar nga ana e Gjykatës Themelore.
48. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 246 [Pranimi i fajësisë] të KPPRK-së *"Pasi që gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues bindet se i pandehuri e kupton aktakuzën, të pandehurit i ofron mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarojë i pafajshëm [...]"*.
49. Për më tepër, Gjykata rikujton praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së sipas së cilës, efektet e pranimi të fajësisë janë se akuza penale ndaj të akuzuarit vendoset përmes një procedure të përsheptuar të shqyrtimit gjyqësor, që nënkupton, në substancë, se të akuzuarit heqin dorë nga një numër i të drejtave të tyre procedurale (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, *Navalnyy dhe Ofitserov kundër Rusisë*, Aktgjykim i 4 korrikut 2016, paragrafi 100). Në këtë aspekt, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës duke pranuar fajësinë lidhur me veprën penale për të cilën akuzohej, në shqyrtimin gjyqësor të 16 tetorit 2019, para Gjykatës Themelore kishte hequr dorë nga disa të drejta të garantuara përmes KPPK-së, dhe kjo është në pajtueshmëri edhe me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së (shih rastin e Gjykatës KI70/21, parashtrues *Burhan Tusha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 qershorit 2021, paragrafi 50).
50. Gjykata rrjedhimisht konstaton se parashtruesi i kërkesës i ka pasur përfitimet e procedurës kontradiktore; ai ka pasur mundësi që në fazat e ndryshme të procedurës t'i paraqesë pretendimet dhe provat të cilat i ka konsideruar si të rëndësishme për rastin e tij, e ka pasur mundësinë për t'i kundërshtuar në mënyrë efektive pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtare, gjykatat e rregullta i kanë dëgjuar dhe shqyrtuar të gjitha pretendimet e tij, të cilat, shikuar objektivisht, kanë qenë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës, arsyet faktike dhe juridike për vendimin e kundërshtuar janë paraqitur në detaje, prandaj, procedura, shikuar në tërësi, ishte e drejtë (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafët 29 dhe 30; shih gjithashtu rastin e Gjykatës

KI22/19, parashtrues: *Sabit Ilazi*, Aktvendim i 7 qershorit 2019, paragrafi 42 si dhe rastin e Gjykatës KI128/18, cituar më lart, paragrafi 58).

51. Andaj, Gjykata vëren se arsyetimi i Gjykatës Supreme, duke iu referuar pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të legjislacionit penal, është i qartë dhe, pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu konstaton se procedurat në gjykatat e rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare. (shih: Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Pekinel kundër Turqisë*, të 18 marsit 2008, nr. 9939/02, paragrafi 55; shih gjithashtu: në këtë kontekst, ndër të tjera, rastin KI22/19, cituar më lart, paragrafi 43).
52. Gjykata gjithashtu rikujton që, parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimet e gjykatave të rregullta janë të kundërligjshme dhe në kundërshtim me Kushtetutën, duke u referuar gjithashtu në rastet e Gjykatës KI120/10 dhe KI72/12.
53. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se përveç faktit që parashtruesi i kërkesës ka cekur dhe ka cituar rastet e Gjykatës KI120/10 dhe KI72/12, ai nuk ka elaboruar lidhshmërinë e tij faktike dhe juridike, me rrethanat e rastit konkret. Gjykata thekson që arsyetimet e vendimeve të tjera gjyqësore duhet të interpretohen në kontekstin dhe në dritën e rrethanave faktike në të cilat janë nxjerrë (shih, ndër të tjera dhe në këtë kontekst, Aktgjykimin në rastin KI48/18 të 4 shkurtit 2019, me parashtrues *Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës* (LDK), paragrafi 275; rastin KI119/17, parashtrues *Gentian Rexhepi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 majit 2019, paragrafi 80; dhe KI115/19, parashtrues *Sadete Jusufi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 prillit 2020, paragrafi 51; KI192/20, parashtrues *Muhamed Aliu*, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 gushtit 2021, paragrafi 45).
54. Gjykata rikujton se fakti i thjeshtë që parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e vendimeve të gjykatave të rregullta apo përmendja e neneve të Kushtetutës nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të sigurojë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih rastet e Gjykatës KI128/18, cituar më lart, paragrafi 61; dhe KI62/19, cituar më lart, paragrafi 59).
55. Në fund, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit të aplikueshëm janë (i) pretendime që kualifikohen si pretendime të “*shkallës së katërt*”; dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet me paragrafin (2) të rregullit 39.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, të nenit 20 të Ligjit dhe të rregullave 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 7 tetor 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese


Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani